

**ROLI PATRIOTIK E INTELEKTUAL I MEHMET PASHË
DERALLËS
Ermir NIKA**

UDK: 930.85(496.5:=18)''18/19''

Abstrakt

Studimeve shqiptare, kohë pas kohe, i janë bashkëlidhur vepra dhe punime të cilat hedhin dritë dhe trajtojnë në këndvështrime të ndryshme, rolin dhe kontributin e protagonistëve të ndryshëm në dobi të çështjes kombëtare. Parë në këtë këndvështrim, shumë studiues i janë rikthyer më shumë se njëherë trajtimit të disa prej momenteve më të rëndësishme të historiografisë kombëtare. Pikërisht ky aspekt, është edhe motivi i organizimit të kësaj veprimtarie, e cila ka në qendër të objektit të saj, vlerësimin për njërin prej personaliteteve më të spikatur dhe të rëndësishëm të historisë sonë kombëtare, Mehmet Pashë Deralla.

Lëvizja Kombëtare, para së gjithash duhet parë jo thjesht si një organizim mbarë shoqëror dhe si një mobilizim e strategji ushtarake, për të garantuar mbrojtjen e tërësisë territoriale në ruajtjen e integritetit të vendit, por edhe si një përpjekje intelektuale për ndërgjegjësimin mbarëshoqëror, me qëllim shpalosjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të identitetit tonë kombëtar. E padyshim, në këtë kauzë të përbashkët, roli dhe kontributi i Mehmet Pashë Derallës ishte një faktor kyç që ndikonte drejtpërsëdrejti në përmbushjen e këtij misioni madhor për realitetin dhe ardhmërinë e ekzistencës së shqiptarëve, kulturës, historisë dhe shtetit të tyre, si pjesë përbërëse e bashkësisë ballkanike dhe evropiane.

Fjalë kyçe: Lëvizje kombëtare, Mehmet Pashë Deralla, Lidhja e Prizrenit.

Duke u rrekur të analizojmë tiparet kryesore që përfaqësojnë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe protagonistët e saj, duhet sërish të ritheksojmë se fryma që e përshkonte në tërësinë e saj këtë dukuri, e karakterizon si të parën lëvizje çlirimtare me karakter kombëtar, në të cilën morën pjesë të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe në të cilën u kombinuan të gjitha format e luftës çlirimtare, që nga kuvendet popullore deri tek parashtrësat politike, që nga misionet diplomatike deri te kryengritjet e armatosura.

“Krahas këtij vargu të pafund kryengritjesh të përgjakshme, kishte zënë fill edhe një revolucion kulturor, i cili, ndonëse më pak i dhunshëm, ishte gjithsesi më dramatik. Kultura e një populli mund të cilësohet si mënyra më e përgjithshme e jetesës dhe mendimit të tij. Antropologët vënë në dukje se ka shumë faktorë që e dallojnë një kulturë nga tjera: gjuha, duke futur këtu fjalorin dhe strukturën gramatikore, origjina racore, historia, organizimi social, mjeshhtëria e ndërtimit të banesave, veshjet, gjuetia, bujqësia, arti luftarak, besimet dhe praktikat fetare, shprehja artistike në muzikë, valle, lojëra, pikturë, skulpturë dhe folklor, si edhe zakonet e traditat. Shumë shkencëtarë, sociologë, do të pajtoheshin me gjuhëtarin e hershëm shqiptar, Sami Frashëri se: “Gjuha është protoplazma e kombësisë”. Pikërisht këtu i ka rrënjët tragjedia shqiptare”.²⁹⁹ Ishte pikërisht Lidhja e Prizrenit e para lëvizje masive, e cila synoi të përmbushte programin madhor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në kushtet e Krizës Lindore të viteve 70 të shekullit XIX, që kishte si qëllim madhor njohjen e kombit shqiptar si një bashkësi të pandarë, mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe formimin e një shteti shqiptar autonom e demokratik. Edhe në trajtesat që i janë bërë deri më tani këtij momenti të rëndësishëm historik, shumë studiues vendas dhe të huaj bien në një mendje me idenë se Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha një shtytje të paparë deri atëherë edhe lëvizjes kulturore shqiptare; përparimet e arritura brenda tre vjetëve të jetës së saj në

²⁹⁹ Edvin Jacques: Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, studim, Sh.B. Kartë e Pendë, Tiranë 1997, f. 309.

fushën e mendimit shoqëror, të letërsisë publicistike dhe të krijimtarisë letrare ishin më të mëdha, sesa hapat e kryer gjatë dhjetëvjeçarëve të mëparshëm.

Lidhja e Prizrenit krijoi, më në fund, një pikë të shëndoshë referimi si me programin e saj politik, ashtu edhe me formën e saj organizative për lëvizjet e mëvonshme çlirimtare të shqiptarëve deri në fitoren e pavarësisë kombëtare, në nëntor të vitit 1912. Mendimi politik, filozofik e shoqëror në vitet e Lidhjes së Prizrenit gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit si pjesë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nuk u shpreh vetëm me luftën e përditshme politike, diplomatike e ushtarake për mbrojtjen e tërësisë tokësore të tokave shqiptare dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Lëvizjen kulturore të kësaj periudhe e udhëhoqën po ata atdhetarë, të cilët përpunuan edhe platformën politike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Atë e udhëhoqën figura të shquara, si Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Sami Frashëri, Thimi Mitko, Ymer Prizreni, të cilët me veprimtarinë e tyre si ideologë e si aktivistë, si shkrimtarë e si organizatorë, zënë një vend të rëndësishëm në historinë e gjithë Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Duke mbetur gjithnjë në lëmin e shpalosjes së mendimit politik e shoqëror, lëvizja kulturore trajtoi problemet kryesore që shqetësonin lëvizjen kombëtare në kushtet e Krizës Lindore të viteve 70: konsolidimin e unitetit kombëtar të shqiptarëve, mbrojtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe formimin e shtetit shqiptar autonom, si hap drejt krijimit të shtetit kombëtar të pavarur, demokratik e iluminist. Një vend qendror në platformën ideologjike, të përpunuar në një varg shkrimesh nga udhëheqësit e lëvizjes kombëtare të këtyre viteve, zuri koncepti filozofik për kombin. Çështja kishte rëndësi jetike për shqiptarët, pasi në arenën ndërkombëtare sundonte ende koncepti mesjetar, i cili e mbante bashkësinë fetare të një populli si një përbërës të domosdoshëm për të qenë një komb.

“Të ngresh besimin fetar në parim kombësie dhe të marrësh dogmën për racë apo ritin për atdhe, nuk është aspak e pranueshme”, shkruante Pashko Vasa më 1879. Veç kësaj rilindësit nuk u pajtuan as me konceptin tjetër që qarkullonte te disa teoricienë të kohës së tyre, sipas të cilëve një popull quhet komb kur ka formuar shtetin. Konceptin filozofik për kombin e formuloi në mënyrë më të plotë Abdyl Frashëri, qysh në pragun e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në artikujt e tij, të botuar në pranverën e vitit 1878, ai shikonte si përbërës të një kombi gjuhën e përbashkët, territorin e përbashkët, historinë e përbashkët dhe jetën shpirtërore të përbashkët (të cilën ai e kërkonte jo në fenë e përbashkët, por në fushën e dokeve, të zakoneve, të tregimeve, të këngëve, të valleve dhe të virtyteve të përbashkëta) dhe mbi të gjitha aspiratën për të formuar një shtet të përbashkët.

Në këto zhvillime roli i Mehmet Pashë Derallës, si një ndër protagonistët kryesorë të këtyre lëvizjeve, nuk ishte vetëm kontributi në dobi të mobilizimit dhe organizimit të trupave luftarake në drejtim të mbrojtjes së tërësisë territoriale shqiptare, por edhe të identitetit kombëtar, të gjuhës, historisë dhe kulturës së saj në tërësi. Orientimi i rezistencës kombëtare dhe betejat që e shoqëronin kohë pas kohe gjithë këtë proces të gjatë e të vështirë të luftës për mëvetësi dhe integritet, siç mund të dallohet qartë edhe nga dokumentacioni i kohës, shihet qartë që një ndër synimet e platformës për sigurinë kombëtare ishte jo vetëm mbrojtja e kufijve shtetërorë e gjeografikë, por edhe paprekshmëria e kufijve gjuhësorë dhe etnokulturorë të Shqipërisë dhe shqiptarëve, një strategji në të cilën Mehmet Pashë Deralla kishte një rol parësor. Lëvizja kulturore shqiptare përvetësoi kështu, në fushën ideologjike, një nga konceptet filozofike më të përparuara të shek. XIX. Ajo e pasuroi më tej kulturën politiko-shoqërore, duke e trajtuar konceptin e autonomisë së Shqipërisë nga këndi i interesave kombëtarë shqiptarë, si një hallkë kalimtare për të sendërtuar, në kushte kombëtare më të përshtatshme, pavarësinë e saj të plotë.

Procesi i laicizmit të ndërgjegjes politike kombëtare ia hapi dyert një depërtimi më të hovshëm të mendimit iluminist në jetën kulturore të vendit, gjë që shpejtoi emancipimin shpirtëror dhe intelektual të shqiptarëve kudo ku ata jetonin e mundoheshin të ndërtonin të ardhmen e tyre. “Kështu programi i plotë politik i porsaformuar nga përfaqësuesit e Lëvizjes Kombëtare u bë platformë e gjithë luftës së popullit tonë. Madje, ai u përvetësua, për aq sa ishte e mundur, brenda një kohe shumë të shkurtër, sepse ky përvetësim u krye në kushtet e një lëvizjeje të thellë dhe të gjerë popullore”³⁰⁰. Sipas mendimit të përgjithshëm të atdhetarëve shqiptarë, e vetmja rrugëdalje nga situata dramatike, që kërcënonte jo vetëm Gadishullin Ballkanik, por edhe Kontinentin Evropian, ishte respektimi i parimit të kombësisë për tërë popujt. Në rast se Shqipëria do të copëtohej midis fqinjëve të saj, Gadishulli Ballkanik nuk do të kishte kurrë qetësi, pasi shqiptarët nuk do hiqnin asnjëherë dorë nga lufta për të fituar të drejtat e tyre kombëtare. Përkundrazi, theksonte Abdyl Frashëri, në rast se Shqipëria do të fitonte të drejtat e saj, “do të vijë dita kur Evropa do të bindet se shqiptarët i shërbejnë çështjes së njerëzimit dhe të qytetërimit më mirë se çdo popull tjetër i Lindjes”.

Hovi që mori lufta për autonominë e Shqipërisë i dha gjithashtu një shtytje të fuqishme lëvizjes në fushën e arsimit e të letërsisë shqipe, të cilat tani synonin jo vetëm të ngrinin në një shkallë më të lartë ndërgjegjen atdhetare të masave popullore, por edhe të përballonin nevojat që shtronte zëvendësimi i administratës osmane me administratën shqiptare. Që me themelimin e Lidhjes së Prizrenit, u ndje më shumë se kurdoherë nevoja e ngutshme për të caktuar alfabetin e njësuar të gjuhës shqipe dhe për t’i dhënë fund anarkisë që sundonte në këtë fushë. Uniteti kombëtar i shqiptarëve që krijoi Lidhja e Prizrenit në fushën politike, u pasqyrua kështu edhe në krijimtarinë popullore

³⁰⁰ Gazmend Shpuza: Në vazhden e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare, Sh.B. Toena, Tiranë 1997, f. 46.

historike. Sipas traditës, rapsodët popullorë krijimet e tyre letrare më monumentale ua kushtuan ngjarjeve historike më të shënuara të së kaluarës historike, por edhe të realitetit objektiv të shqiptarëve. Në shërbim të kërkesave nacionale, gjithkund nëpër rajonet shqipe, u gjendën patriotët shqiptarë, të cilët edhe pse pa kualifikimet e duhura, e morën përsipër barrën e mësimit të bashkëkombësve të tyre për të mësuar dhe zotëruar gjuhën amtare shqipe. “Klubet qenë njësitë nismëtare për hapjen e shkollave, seminareve, kurseve dhe përgjithësisht për zhvillimin e kulturës shqipe. Klubet kujdeseshin për mirëmbajtjen e tyre dhe për sigurimin e mësuesve. Shkollat shqipe të asaj kohe u bënë fole të zgjimit të vetëdijes dhe bashkimit kombëtar. Në këto shkolla, së bashku mësonin shqiptarë myslimanë, katolikë dhe ortodoksë dhe bashkërisht jepnin kontribut në forcimin e vetëdijes kombëtare, duke mos rënë nën ndikimin e politikës osmane për dallim fetar”³⁰¹.

Përfundim

Krijimi i institucioneve shtetërore, por edhe i organizatave patriotike, si dhe mbrojtja e konsolidimi i mëtejme i tyre, ishte një mjet dhe hallkë e rëndësishme që siguronte vazhdimësinë e tyre dhe për rrjedhojë të krejt këtij kalvari shumëshekullor të shqiptarëve për të krijuar një shtet të pavarur, duke i veshur atij të gjithë vlerat dhe traditat e tij historike dhe kulturore. Për rrjedhojë, harmonizimi dhe bashkërendimi i pikëpamjeve dhe detyrave të gjithsecilit nga krerët dhe protagonistët e gjithë kësaj lëvizjeje, ndikuan fort që kjo platformë e përbashkët ideologjike, patriotike, politike, ushtarake e kulturore, të precipitonte në aktin e themelimit të një shteti të pavarur shqiptar dhe të sensibilizimit të autoriteteve dhe shteteve të huaja, për rëndësinë e madhe që kish njohja e Qeverisë Shqiptare dhe e programit të saj, si një ndër faktorët më me rëndësi në paqen dhe stabilitetin në Gadishullin e Ballkanit, edhe

³⁰¹ Myzafer Bislimi: Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk, studim, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2008. f. 134 – 135.

udhëhequr tashmë nga figura me integritet dhe peshë të konsiderueshme edhe në marrëdhëniet politike e diplomatike të kohës.

Bibliografia

Kulla, Ndriçim: Antologjia e mendimit shqiptar, Shtëpia Botuese Plejad, Tiranë 2003, f. 1004.

Jacques, Edvin: Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, studim, Sh.B. Kartë e Pendë, Tiranë 1997, f. 785.

Shpuza, Gazmend: Në vazhden e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare, studim, Sh.B. Toena, Tiranë 1997, f. 344.

Bislimi, Myzafer: Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk, studim, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2008. f. 265.

Sinani, Arsim: Neoshqiptarizmi i Mehmet Pashë Derallës, revista Diskutime nr.11